



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**Lënda:** Përgjigje kërkesës nr. 2, të paraqitur nga Z. A.E.  
Adresa: \_\_\_\_\_

I nderuar z. E.

Referuar kërkesës tuaj për informacion nr. 1010/2 prot. datë 23.06.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) ku i rikërkohet institucionit në mënyrë shteruese njohja me procedurën e ndjekur dhe dokumentacionin përkatës referues që përmendet, konkretisht;

- i. vendimin e institucionit për legjitimitetin e palës kërkuese,
- ii. kopje të kërkesës,
- iii. ofrimin dhe vënien në dispozicion,
- iv. mënyrën e marrjes së dokumentacionit,
- v. marrjen e masave administrative dhe ligjore përkatëse për gjithë personat e përfshirë, dëshirojmë t'ju informojmë si më poshtë:

Së pari : Sic edhe ju informuam me shkresën nr. 1010/2 prot. datë 15.06.2023 (tonën), për trajtimin e kërkesës mediatike të depozituar nga Publik TV (përfaqësuar nga N.N.) dhe E.Gj., nga ana e Autoritetit, është ndjekur procedura për shqyrtimin e dokumenteve, vënien në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve nga media, sipas dispozitave të përcaktuara nga ligji i posaçëm të Ligjit nr. 45/2015, dhe Udhëzuesit “Për studiues/media, janë garantuar kushtet që qasja me dokumentacionin të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje.

Së dyti : pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësohet se objekti i kërkesës, lidhet me pretendimin se jeni cënuar në të drejtat tuaja nga veprime të personave që në mënyrë abuzive dhe të pa-autorizuar kanë përfituar informacion, e kanë administruar në mënyrë të paligjshme dhe e kanë keqpërdorur atë.

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se : “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, dhe ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji, të cilat mundësojnë kryerjen e verifikimeve administrative me qëllim qartësimin e rrethanave dhe fakteve të çështjeve të caktuara, Autoriteti ka marrë në shqyrtim kërkesën për kryerjen e një verifikimi administrativ lidhur me pretendimet e ngritura.

Procedura e verifikimit administrativ, veprimet verifikuese, të drejtat e palëve, etj, parashikohet të realizohet brenda një afati 2 mujor sipas dispozitave ligjore në fuqi, neni 91 Kodi i Procedurave Administrative.

Në përfundim të afatit kohor 2 mujor për përfundimin e procedurës së verifikimit, me vendim përfundimtar do të njoftohen të gjithë palët e interesuara për rezultatin e verifikimit të kryer.

Së treti : e drejta për tu njohur me dokumentet e praktikës, është qartazi e ndarë nga e drejta e informimit mbi dokumentet zyrtare të administratës, njohja e të cilave i nënshtrohet ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pra e drejta rrjedh nga cilësia e të qenit një qytetar, një e drejtë e përgjithshme që ka çdo qytetar me administratën e shtetit të tij.

Ndërkohë që e drejta për tu njohur me dokumentet e praktikës sipas pretendimit se jeni cënuar në të drejtat tuaja, rrjedh nga pozita ligjore e palës në një procedurë administrative.

Në respektim të kërkesave të ligjit nr 119/ 2014, lutemi gjeni bashkëngjitur kopje të vendimit të shkurtuar të Autoritetit nr. 307 datë 08.05.2023, për vënien në dispozicion, të kërkuësve, të dokumentacionit dublikatë.

Dokumentacionin e sipercituar mund ta aksesoni edhe në faqen zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Financave**

**Sofi Noti**